Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
U. 01 Nr./Br. 26693
faq./Br. str. 1 Data/Datum: 21/08. 2024
KAMENICE/A

**Kuvendi Komunal i Kamenicës**
**Datë: 20.08.2024**

Mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,

Kryesuesi i Kuvendit me datë: 20.08.2024 :

**T H Ë R R E T**

Mbledhjen e VIII-të (të rregullt) të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Premte** me datë: **30.08.2024**, duke filluar nga ora **10:00.**

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit, nga mbledhja e 7-të e Kuvendit Komunal për vitin 2024.
2. Pyetje legjislativit drejtuar ekzekutivit.
3. Propozim-Vendim për shfuqizim të vendimit nr.21033.
4. Propozim-Vendim për shfuqizim të vendimit nr.21061.
5. Propozim-Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit bazë nr.21059.
6. Të ndryshme.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS * OPSTINA KAMENICA
01 KUVENDI I KOMUNËS * SKUPŠTINA OPSTINA

**Liridon KASTRATI**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 26694
Nr. i faq. Br. str. 5 Data: Datum: 21.08.
KAMENICE/A 2024

**PROCESVERBAL**

**Nga mbledhja e VII-të e Kuvendit të Komunës**

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës më: 29.07.2024 dhe filloj ora 10:10. Në mbledhje përveç delegatëve të kuvendit, të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, Zyrtari Kryesor Financiar, Shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi, Zyrtari për Integrime Evropiane, zyra e informimit dhe OSBE. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Liridon Kastrati i cili për mbledhje propozoi këtë:

**Rend dite**

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 6-të e Kuvendit Komunal për vitin 2024,**
2. **Pyetje të legjislativit drejtuar ekzekutivit,**
3. **Raporti i punës së Kryetarit për periudhën gjashtëmujore 01.01.2024-30.06.2024,**
4. **Raporti tremujor Financiar Prill-Qershor 2024,**
5. **Informatë rreth aktiviteteve të KKSB-së për (gjashtëmujorin) e parë të vitit 2024,**
6. **Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kamenicës për vitin 2023,**
7. **Kërkesë nga MAPL-ja nr. 04/5685, për harmonizimin e Vendimit nr.21038,**
8. **Propozim-vendim për transfer dhe rialokim të mjeteve**
9. **Të ndryshme**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**, para se me filluar konstatojmë se kemi kourum të mjaftueshëm për të filluar seancën, a keni propozime për plotësim-ndryshim të rendit të ditës? Nëse nuk keni, e hedhim në votim rendin e ditës,
**Kush është për miratimin e rendit të ditës?**
**Për......................të gjithë.**
**Kundër..............0**
**Abstenim............0**

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 6-të e Kuvendit Komunal për vitin 2024,**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**- kemi pikën e parë të rendit të ditës, a keni vërejtje rreth procesverbalit , nëse nuk keni e hedhim në votim.
**Kush është për miratimin e pikës së parë?**
**Për..........................17**
**Kundër ....................0**
**Abstenim................0**

2. **Pyetje të legjislativit drejtuar ekzekutivit,**

**Naim Arifi**-në lagjen "Çamëria " ka qenë një defekt një shtyllë është rrëzuar dhe një pjesë e lagjes nuk ka ndriçim.
**Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës**, këtë çështje që e ngriti z. Naim Arifi, do ta adresoj tek drejtoria pasi që kontrata për mirëmbajtje është ende aktive.

3. **Raporti i punës së Kryetarit për periudhën gjashtëmujore 01.01.2024-30.06.2024,**

**Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës**-me ligjin për vetëqeverisje lokale jemi të obliguar të mbajmë dy dëgjime buxhetore për të paraqitur raportin e punës Janar-Qershor. Dëgjimin e parë e kemi mbajtur në sallën e kuvendit komunal ku ka qenë më i detajuar dhe më specifik. Ndërsa, raporti i punës që sillet në kuvend, përveç atij raportit që i paraqitet zyrtarëve janë edhe proceset administrative që kryejnë drejtorit përkatëse deh sektorët e drejtorive përfshirë edhe sektorët që janë në kuadër të zyrës së kryetarit siç janë zyra e prokurimit, zyra e burimeve njerëzore. Është një raport voluminoz dhe ka shifra të theksuara. Për ato që jeni për ti shpalosët më gjatë e më shumë ne jemi këtu për t'iu përgjigjur.
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**-a keni diskutime rreth këtaj pike, nëse nuk keni kalojmë në pikën e 4-të të rendit të ditës.

4. **Raporti tremujor Financiar Prill-Qershor 2024,**

**Ardita Dërmaku-Drejtoresh për Buxhet dhe Financa**, para jush do të paraqesim raportin tre mujor financiar Prill, Maj, Qershor 2024, këtë raport e kemi përgatitur në bazë të ligjit për Menaxhimin e Financave neni 45 paragrafi 45.2, 45.4, 46.1. Sa i përket Performanca e të hyrave , gjithsej të hyrat vetanake të Komunës gjatë tremujorit të dytë kanë shënuar shumën 250,875.02€ apo 50.27% më pakë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Zvogëlimi ka qenë kryesisht nga të hyrat në taksa e tatimit në pronë, Taksa për rexhistrim të biznesit, ,shfrytëzimi i pronës publike, taksa për leje ndërtimi etj. Sa i përket performanca e shpenzimeve kanë arritur në 4,500,486.68 € përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, apo 47,30% më shumë krahasuar me shpenzimet e realizuara gjatë së njëjtës periudhë të vitit paraprak. Siç e dini shpenzimet ndahen për shpenzime për paga dhe mëditje, për mallra dhe shërbime, subvencione dhe investime kapitale. **Shpenzimet për *paga dhe mëditje*** kanë shënuar rritje prej 44,93% krahasuar me vitin 2023 gjatë këtij tremujori, shënuan vlerën prej ***3,396,675.18€,*** duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 37.77% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori për këtë periudhë. Bazuar në buxhetin e tërësishëm kjo kategori është realizuar 72.58% gjatë periudhës Janar –Qershor 2024. Kjo rritja ka rezultuar pagesat e vendimeve gjygjësore në shumë prej 1,285,678.59€. **Shpenzimet në *mallra dhe shërbime*** kanë shënuar rritje prej 56.22% krahasuar me vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur në ***513,265.96 €***, kjo shumë

korrespondon me 21.92% të buxhetit për këtë kategori për periudhën prill-qershor 2024. ***Shpenzime në komunali,*** kanë shënuar një rritje të lehtë 14.11% € krahasuar me vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur në 57,061.58€ apo 22.43% të buxhetit për këtë kategori për periudhën prill-qershor 2024.□**Shpenzimet në *subvencione dhe transfere,*** shënuan rritje prej **224.74%** € krahasuar me vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur në 263,579.29€ apo 38.97% të buxhetit për këtë kategori për periudhën prill-qershor 2024. ***Shpenzimet kapitale.*** Ato arritën vlerën prej **269,904.67 €**, që është 7.99% më shumë krahasuar me periudhën e njëjte nga viti i kaluar .Ekzekutimi 9.04% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori për këtë periudhë. Bazuar në buxhetin e tërësishëm kjo kategori është realizuar 9.04%.gjatë periudhës Janar –Qershor 2024.

**Magbule Kastrati**-shtesa e veçanta për të zgjedhurit, shpenzimet shëndetësore në vlerë prej 415 euro . Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit 5 539.10.

**Ardita Dërmaku-Drejtoresh për Buxhet dhe Financa**-vlera është 7 896 nga kjo kategori paguhen anëtarët e Komiteteve. Asgjësimi i barnave të cilat nuk përdoren. Kompensimi për përfaqësimin brenda vendi, fjala është për dreka zyrtare.

**Jadranka Nikolic**-pasi u përmend pagesa për Komitetin për Politikë dhe Financa, pyes se kush është paguar dhe kur janë paguar? Ky raport a është vetëm për Qershor apo nga muaji Janar? Kujt iu është paguar a mundeni me treguar me emra për këtë periudhë kohore ?

**Ardita Dërmaku-Drejtoresh për Buxhet dhe Financa,** këtu është fjala për Janar-Qershor 2024, ky raport përfshinë raportin Prill-Qershor për tremujorin e dytë të periudhës. 2024, por kemi pasën raste kur i kemi përkufizuar edhe komplet shpenzimet e viti deri më tani. Sa i përket listës mund ta ofrojë personeli për pagesat që janë bërë.

**Rabit Dërmaku**-ne marrim një pagë nga kuvendi dhe kam vërejt një risi që disa asambleist 2 mbledhje vinë në seancë dhe 1 mbledhje nuk vinë dhe paguhet me pagë të plotë, por kur është në pyetje tek Komiteti për Politikë dhe Financa vinë të gjithë ngase paguhet si mëditje. Si kryesues i kuvendit a e keni vërejt se disa asambleist nuk janë dy mbledhje, kurse një mbledhje janë prezent?

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**- sa i përket ligjit të ri të pagave, asambleistat paguhen me pagë mujore, ndërsa në Komitet për Politikë dhe Financa është me mëditje. Nëse një asambleist nuk merr pjesë 3 ose 6 seanca të rregullta rradhazi është ligji që e thekson se ndëshkohet dhe e humb mandatin e asambleistit. Dhe për këtë arsye dy seanca nuk marrin pjesë, kurse një seancë marrin pjesë për me qenë në harmoni me kërkesën e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

**Rabit Dërmaku**-nëse një delegat ka udhëtim zyrtar, ose probleme shëndetësore është në rregull, por me marrë pagën edhe me munguar dy muaj, kurse muajin e tretë mos me ardhën kjo nuk është e ndërgjegjshme as nga kolegët e mijë, ngase ne jemi pasqyrë e komunës ngas ekur ishte me ligjin e vjetër në sall ishin të gjithë prezent.

**Jadranka Nikolic**, sipas udhëzimeve ligjore këshilltarët komunal paguhen 30% pyetja ime është si paguhen anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa a është me përqindje të pagës apo diçka tjetër ?

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**-sa i përket anëtarëve të KPF-së është e përcaktuar me ligjin për paga dhe rregulloret të brendshme që janë 30% të pagës së asambleistit. Ne i dërgojmë listën për pagesë tek zyra e personelit, pastaj ata mirren me pagesë.

**Jadranka Nikolic**-mos ma ndërpreni kohën, unë kur kam munguar në seancë nuk jam paguar edhe pse jam munduar ta arsyetoj mos prezencën time. Unë do të fotografoj dhe do të tregoj për ata që nuk janë preznet në mbledhje.

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**-ne pasi të përfundojmë mbledhjen mund të shkojmë tek zyra e personelit dhe të shikohet se në cilat mbledhje ke

marrë pjesë dhe në cilat jo, dhe mund të shikosh pagesat, ngase çështja e pagesave bëhet përmes zyrës së personelit. Nëse nuk keni pyetje të tjera kalojmë në pikën e 5-të.

5. **Informatë rreth aktiviteteve të KKSB-së për (gjashtëmujorin) e parë të vitit 2024,**

**Fisnik Kastrati-Koordinator i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**, KKSB-ja gjatë këtij viti është duke ju përmbajtur planit të punës, deri më tani ka mbajtur tri takime të rregullta, nga 6 që do të mbahen gjatë vitit 2024. Unë nuk kam të shtoj diçka nëse keni pyetje unë jam këtu për përgjigje.
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**-a keni pyetje rreth kësja pike, nëse nuk keni kalojmë në pikën e gjashtë.

6. **Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kamenicës për vitin 2023,**

**Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës**-materialin e keni marrë, fatkeqësisht komuna e Kamenicës prap vuan për pasojën e kontratës kolektive që për shkak të përmbaruesve privat ekzekutohen mjete financiare në llogaritë e përfituesve nga kategoritë shpenzuese të buxhetit jo adekuate dhe kjo ka bërë që komuna e Kamenicës të marr opinion të kualifikuar. Janë edhe dy çështje të tjera e para ka të bëjë edhe me përllogaritjen e gabuar e detyrimeve kontingjente që pak a shumë është e vështirë të kalkulohet nga përfaqësuesi ligjor i komunës së Kamenicës fjala është për konteste gjyqësore ku komuna paditet nga palë të ndryshme dhe vlera e dëmit nuk mund të llogaritet në sasinë e plotë sepse mund të ketë edhe ekspert të angazhuar nga gjykata apo edhe fjalën përfundimtare mund ta thotë edhe vetë gjykata .Kemi edhe një problem tjetër mos regjistrimit i pasurive jo financiare, ne i kemi marrë hapat konkret duke i themeluar edhe komisionet që mund të rregullohen në mënyrë administrative nga Komuna e Kamenicës të mos përsëriten, ndërsa qysh tani e kuptojmë që komuna e Kamenicës edhe vitin e ardhshme mund të ketë një opinion të kualifikuar për shkak që muajin e kaluar janë ekzekutuar 2.4 milion euro nga përmbaruesit privat dhe kryesisht janë pagesa për shujta të mësimdhënësve dhe kjo ka ndikuar edhe në strukturat buxhetore që jemi detyruar që të bëjmë edhe një propozim-vendim të mjeteve financiare 4 milion euro nuk janë ekzekutuar nga kategoria e pagave dhe ka prekur kategoritë e investimeve kapitale, shërbimeve subvencioneve dhe mallrave. Për mos me u fut në obligime më të mëdha kemi edhe pikën e tetë për transfer dhe rialokim të mjeteve me mundësitë që kemi në kategoritë e ndryshme për obligimet që ka tani komuna dhe ti përfundojmë brenda këtij viti. Janë vetëm tri komuna në Kosovë që nuk kanë pasur pasqyrë financiare ose opinin të auditimit opinion të kualifikuar.
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**- a keni pyetje rreth kësaj pike, nëse jo kalojmë në pikën e 7-të.

7. **Kërkesë nga MAPL-ja nr. 04/5685, për harmonizimin e Vendimit nr.21038,**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**-kjo ka të bëjë me vendimin e seancës së fundit ku nga MAPL-ja janë gjetur disa vërejtje që të njëjtin akt edhe njëherë ta harmonizojmë. Ky akt është bazuar në ligjin është bazuar në ligjin për transportin rrugor që është ndryshuar para dy jave e që kanë kërkuar që bazën të cilën u bazua vendimi të bazohet tek ligji i ri. Për këtë arsye kanë kërkuar që disa nene të harmonizohen me ligji e ri. A keni diskutime për këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk keni e hedhim në votim,
**Kush është për miratimin e pikës së tretë?**

**Për............................16**
**Kundër .....................0**
**Abstenim...................0**

## 8. Propozim-vendim për transfer dhe rialokim të mjeteve

**Naser Hashani-Zyrtar Kryesor Financiar,** kjo është një kërkesë që është bazuar në ligjin për buxhet në nenin 15 dhe 16, ku janë të lejuara transferet për kategori të ndryshme në normën e përqindjes që janë të rregulluara me ligj. Ne kemi parë të arsyeshme që nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve që për shkak edhe të ekzekutimeve të aktvendimeve të gjykatës që janë bërë nga departamenti i thesarit kemi ngecë në disa kategori ekonomike sidomos te kategoria për subvencione që janë ekzekutuar aktvendimet e gjykatës këtë e kemi bërë të pamundur që gjatë analizave të buxhetit kemi dashur që kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ta bëjmë rialokimin në kategorinë e subvencioneve. Një kategori tjetër që e keni në fund të këtij materiali është për investime kapitale janë disa projekte që janë bartur nga vitit i kaluar që kanë përfunduar ato projekte, por që evidentohen në tabelat e buxhetit. Kemi edhe një projekt që është me shtesë që duhet të ekzekutohet, kemi bërë kërkesën që ky rialokim për kategorinë e investimeve kapitale të shkojë në projektin që kërkohet ajo shtesë e buxhetit.
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-**a keni diskutime për këtë pikë, nëse nuk keni diskutime e hedhim në votim,
**Kush është për miratimin e kësaj pike?**
**Për............................16**
**Kundër .....................0**
**Abstenim...................0**

## 9. Të ndryshme

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal,** a keni diskutime të tjera, nëse jo e shpalli të mbyllur takimin e sotëm.

Takimi mbyllet në orën 10:55

**Procesmbajtëse**
______________
**Sabile Arifi**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës**
______________
**Liridon Kastrati**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 26694
Nr. i faq. Br. str. 5 Data: Datum: 21.08.2024
KAMENICË/A

# Z A P I S N I K

## Sa VII –e sednice Skupštine Opštine

Sednica održana dana: 29.07.2024 u opštinskom objektu i počela u 10:10. Na sednici osim odbornika Skupštine Opštine, prisutni bili i Predsednik Opštine, nekoliko direktora opštinskih odeljenja, Glavni Finansijski Službenik, Stručna skupštinska Služab, prevodilac, Službenik za Evropske Integracije, kancelarija informisanja i OEBS-a. Sednicu otvorio i predsedavao Predsedavajući Skupštine Opštine, Liridon Kastrati koji za sednicu predložio ovaj:

**Dnevni red**

1. **Razmatranje i usvajanje zapisnika sa 6 sednice Skupštine Opštine za 2024 godinu,**
2. **Pitanja zakonodavstva upućena izvršnoj vlasti,**
3. **Izveštaj rada Predsednika za šestomesečni period 01.01.2024-30.06.2024,**
4. **Tromesečni Finansijski Izveštaj April-Juni 2024,**
5. **Informacija o aktivnostima OSBZ-e za prvo (šestomesečje) 2024 godine,**
6. **Izveštaj Revizije o godišnjim finansijskim pregledima Opštine Kamenica za 2023 godinu,**
7. **Zahtev MALS-a br. 04/5685, za usklađenje Odluke br.21038,**
8. **Predlog odluke za transfer i preraspodelu sredstava,**
9. **Razno.**

**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica**, pre nego počnemo da zaključimo da imamo dovoljan kvorum za početak sednice, imate li predlog za izmene i dopune dnevnog reda? Ako nemate, stavljam na glasanje dnevni red,
**Ko je za usvajanje dnevnog reda?**
**Za....................svi.**
**Protiv...............0**
**Uzdržano..........0**

1. **Razmatranje i usvajanje zapisnika sa 6 sednice Skupštine Opštine za 2024 godinu,**

**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica** – imamo prvu tačku dnevnog reda, ako imate primedbu na zapisnik, ako nemate stavljamm na glasanje.
**Ko je za usvajanje prve tačke dnevnog reda?**
**Za....................17.**
**Protiv...............0**
**Uzdržano.........0**

2. **Pitanja zakonodavstva upućena izvršnoj vlasti,**

**Naim Arifi**-u naselje "Çamëria " imali smo kvar, jedan stub je pao i deo naselja nema rasvetu.
**Kadri Rahimaj-Predsednik Opštine Kamenica**, ovu stvar koju potegao g. Naim Arifi, preneću kod odeljenja pošto ugovor za održavanje je još u funkciji/aktivan.

3. **Izveštaj rada Predsednika za šestomesečni period 01.01.2024-30.06.2024,**

**Kadri Rahimaj-Predsednik Opštine Kamenica**-zakonom o lokalnoj samoupravi moramo da održimo dva budžetske rasprave da bi podneli izveštaj rada Januar-Juni. Prvu raspravu smo održali u sali Skupštine opštine, i bio detaljan i specefičan. Dok izveštaaj rada koji se dostavlja na skupštinu, osim izveštaja koji se predstavlja službenicima tu su još i administrativni procesi koji izvršavaju dotična odeljenja i službe odeljenja uključujući i sektor odeljenja koji su u sklopu kancelarije predsednika kao što su kancelarija za ljudske resurse, kancelarija nabavke itd.To je obiman izveštaj i ima cifre. Ako ste zato da se više i duže razotkriva, mi smo ovde da bi odgovorili.
**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica** –ima li diskusije o ovoj tački, ako nema prelazimo kod 4 tačke dnevnog reda.

4. **Tromesečni Finansijski izveštaj April-Juni 2024,**

**Ardita Dërmaku-Direktorka za Finansije i Budžet,** pred vama iznešćemo tromesečni finansijski izveštaj April, Maj, Juni 2024, ovaj izveštaj smo pripremali na osnovu Zakona o Upravljanju Finansijama, član 45 stav 45.2, 45.4, 46.1. Što se Učinka prihoda tiče, sopstveni prihodi ukupno za Opštinu za drugo tromesečje naznačili iznos 250,875.02€ ili 50.27% manje u poređenju sa istim periodom prethodne godine. Smanjenje uglavnom bilo od prihoda takse poreza na imovinu, Taksa za registraciju preduzeća, korišćenje javne imovine, taksa za građevinsku dozvolu itd. Što se učinka troškova drugog tromesečja 2024 tiče dostigli na 4,500,486.68 €, ili 47,30% više u poređenju sa realizovanim troškovima istog perioda prethodne godine. Kao što znate troškovi se dele na troškove za plate i dnevnice, robe i usluge, subvencije i kapitalne inevsticije.
**Troškovi za *plate i dnevnice*** u poređenju sa 2023 godinom tokom ovog tromesečja obeležili povećanje od 44,93%, ili iznos od ***3,396,675.18€,*** tako dostiglo stopu izvršenja na 37.77% u poređenju sa celokupnim budžetskim iznosom za ovu kategorijuori za ovaj period. Na osnovu celokupnog budžeta ova ketegorija tokom perioda Januar-Juni 2024 je realizovana 72.58%. Ovo povećanje rezultiralo zbog isplate sudskih odluka u iznosu od 1,285,678.59€.
**Troškovi za *robe i usluge*** obeležili povećanje od 56.22% u poređenju sa 2023 godinom. Tokom perioda vrednost ovih troškova dostigla na ***513,265.96*** €, ovaj iznos odgovara sa 21.92% budžeta za ovu kategoriju za period april-juni 2024.

***Komunalijski troškovi,*** obeležili blago povećanje 14.11% € u poređenju sa 2023 godinom. Tokom ovog perioda vrednost ovih troškova dostigla na 57,061.58€ ili 22.43% od budžeta za ovu kategoriju za period april-juni 2024.

□**Troškovi u *subvencije i transfere,*** u poređenju sa 2023 godinom obeležili smanjenje od **224.74%** €. Tokom ovog perioda vrednost ovih troškova dostigla na 263,579.29€ ili 38.97% od budžeta za ovu kategoriju za period april-juni 2024.

***Kapitalni troškovi.*** Dostigli vrednost od **269,904.67** €, što je 7.99% više u poređenju za isti period iz prošle godine. Izvšenje 9.04% upoređeno ukupnim budžetskim iznosom za ovu kategoriju za ovaj period. Na osnovu ukupnog budžeta tokom ovog perioda Januar–Juni 2024 za ovu kategoriju je realizovan 9.04%..

**Magbule Kastrati**-posebni dodaci za izabrane, zdravstveni troškovi u iznosu od 415 evra. Naknada zastupanja u zemlji 5 539.10.

**Ardita Dërmaku-Direktorka za Finansije i Budžet** –vrednost je 7 896 iz ove kategorije plaćaju se članovi Komiteta. Uništavanje lekova koji se ne koriste. Naknada za zastupanje unutar zemlje, radi se službenih ručkova.

**Jadranka Nikolić**-pošto se spominjalo isplata za Članove Komiteta za Politiku i Finansije, postavljam pitanje kome je plaćeno i kada je plaćeno? Meni nije jasno koliko mi dnevnica nedostaju odnosno koliko mi je isplaćeno i koliko ne. Jer, zaista ukoliko si odsutan na jednoj od sednica ili u ovom slučaju to pričam za sebe, odsutna onda zaredom ako sam napravila minus za jedno odsustvovanje ide se redom i ne plaća se. Žalila i obratila se i kadrovskoj službi i predsedavajućem Skupštine i ne znam kome još da se obratim ali odgovor zaista nisam dobila povodom ovoga. Možete li da nam poimenično da dostavite za ovo vreme to jest za ovaj vremenski period, odosno za ovih sedam meseci kome je plaćeno i kome nije. O izveštaju, da li se radi od januara ili samo za juni mesec, za finansijski izveštaj pitam?

**Ardita Dërmaku-Direktorka za Finansije i Budžet,** ovde radi se za period Januar-Juni 2024, dok ovaj izveštaj prikazuje period vremena april-juni tj, za ovo poslednje tromesečje za 2024 godinu. Ali smo imali prilike da smo troškove kompletno do sada ograničili. Što se spiska za isplatu za prisustvo ili ne na sednice može vam pružati kancelarija osoblja za isplate koje su izvršene.

**Rabit Dërmaku-**mi od Skupštinu primamo po jednu platu i primetio sam jednu novinu, neki odbornici na 2 sednice dolaze i na 1 ne dolaze i plaćaju se punom platom, ali kada je u pitanju Komitet za Politiku i Finansije svi dolaze jer se plaća dnevnica. Kao predsedajući da li ste primetili da neki odbornici na dve sednice nisu prisutni, dok na jednu jesu?

**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica** – što se zakona o platama tiče, odbornici se plaćaju mesečnom platom, dok u Komitet za Politiku i Finansije dnevnicom. Ako jedan odbornik ne prisustvuje u 3 ili 6 sednica redovnih postoji zakon koji naglašava da se kažnjava i gubi mandat odbornika. I zato dve sednice ne prisustvuju, a na jednoj prisustvuju da bi se usalglasilo sa zahtevom Zakona o Lokalnoj Samoupravi.

**Rabit Dërmaku**-ako odbornik službeno putuje, ili ima zdravstvenih problema u redu je, ali da prima platu i bude odsutan dva meseca, dok treći mesec da dođe to nije savesno ni od mojih kolega, jer mi smo opštinsko ogledalo jer kada je to bilo starim zakonom u sali svi su bili prisutni.

**Jadranka Nikolić,** po zakonskim propisima opštinski odbornici plaćaju se 30%, moje pitanje je kako se plaćaju članovi Komiteta za Politiku i Finansije da li je procentualno iz plate ili kako je?

**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica** –što se članova KPF-e utvrđeno je zakonom za plate i internim propisima da su 30% od plate odbornika. Mi spsiak za isplatu dostavljamo kancelariji osoblja, posle oni se bave isplatom.

**Jadranka Nikolić**-nemojte me prekinuti u vremenu, kada sam bila na sednicu nije mi plaćeno, mada sam se trudila da se moje odsustvo opravdava. Praviću snimke i pokazaću o onima koji nisu prisutni na sednicu.
**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica** –po završetku sednice ići ćemo kod kancelarije za kadrovska pitanja i vidimo na kojim sam sednicama sam prisustvovala i na kojim odsutvovala, i možeš da se uveriš o isplati, pošto isplata se vrši preko kancelarije osoblja. Ako nemate drugih pitanja prelazimo kod 5 tačke.

**5. Informacija o aktivnostima OSBZ-e za prvo (šestomesečje) 2024 godine,**

**Fisnik Kastrati-Koordinator Opštinskog Saveta za Bezbednost u Zajednici,** OSBZ-e, tokom ove godine se podržava plana rada. Do sada održao tri redovna sastankam od 6 koji će se održati 2024 godine. Nemam šta drugo da dodam , ako imate pitanja tu sam za odgovor.
**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica** –imate li pitanja po ovoj tački, ako nema prelazimo na šetu tačku.

**6. Izveštaj Revizije o godišnjim finansijskim pregledima Opštine Kamenica za 2023 godinu**

**Kadri Rahimaj-Predsednik Opštine Kamenica**-materijal ste primili, na žalost Opština Kamenica ponovo pati za posledicama kolektivnog ugovora zbog priavtnih izvršitelja, izvršavaju se finasijska sredstva u kategorijama potrošnje budžeta neadekvatno i to je učinilo da opština Kamenica zauzme kvalifikovano mišljenjje. Postoje još dve druge stvari, prva se odnosi pogrešnog proračunjavanja potencijalnih obaveza, što je teško obračunati od strane zakonskog zastupnika opštine Kamenica, jer je o sudskim sporovima kojim opština od raznih stranaka i vrednost štete ne može se obračunati u punoj količini jer je moguće postojati angažovanih stručnjaka od suda ili i poslednju reč može da daje sam sud. Imamo još jedan problem neregistrovanje nefinansijske imovine, preduzeli smo konkretne korake vraćajući i komisije koje mogu da se administrativno regulišu od Opštine Kamenica da se ne ponove, dok još sada jasno nam je da opština Kamenica i sledeće godine može imati jedno kvalifikovano mišljenje jer prošli mesec je izvršeno 2.4 miliona od priavtnih izvšitelja i uglavnom su topli obrok nastavnika i to uticalo i u budžetskim strukturama što moramo da napišemo predlog odluke za finansijska sredstva za 4 miliona evra. Nisu izvršene iz kategorije plate i dotakla kategorije kapitalnih investicija, uslugama robe i usluge. Da se ne bi zadužili u velike dugove imamo i osmu tačku za transfer i preraspodelu sredstava o mogućnostima koje imamo u raznim kategorijama za obaveze koje opština sada ima i za ovu godinu završimo. Tri opštine jedine su koje nisu imale finansijski pregled ili mišljenje revizora, kvalifikovano mišljenje.
**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica** – ima li pitanja o ovoj tački, ako nem prelazimo na 7 tačku.

**7. Zahtev od MALS-a, br. 04/5685, za uskladivanje Odluke br.21038,**

**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica** –to se odnosi odluke poslednje sednice, gde MALS-a je pronašlo nekoliko primedbe da se isti dokument odmah uskladi. Ovaj akt je zasnovan na zakon za drumski saobraćaj koji je pre dve nedelje izmenjen na koji da se odluka oslonnja na novi zakon. Iz tih razloga tražili da se neki članci usklade sa novim zakonom. Imate li diskusiju po ovoj tački dnevnog reda, ako nemate stavljamo na glasanje. Imate li diskusije po ovoj tački, ako nemate stavljam na glasanje,
**Ko je za usvajanje treće tačke?**
**Za.........................16**

**Protiv......................0**
**Uzdržano................0**

**8. Predlog odluke za transfer i preraspodelu sredstava**

**Naser Hashani-Glavni Finansijski Službenik,** to je zahtev, zasnovan na zakon o budžetu u članu 15 i 16, sredstva su odobrena za razne kategorije u stopi procenta koje je zakonom regulisano. Mi smo opravdali da se od kategorije za robe i usluge da i zbog izvršenja sudskih rešenja koja su odrađena od departmana trezora u nekoliko ekonomskih kategorija smo zaglavili posebno kod kategorije za subvencije rešenja koja su izvršena. Uradili smo nemoguće da tokom analize budžeta želeli smo da kod kategorije za robe i usluge pravimo preraspodelu u kateogijru subvencija. Druga kateogorija koju imate na kraju ovog materijala je za kapitalne investicije, ima nekoliko projekata koji se prenešni iz prošle godine projekti koji su završeni, ali su evidentovani u tabelama budžeta. Imamo još jedan projekat koji je sa dodatkom i koji treba izvršiti, podneli smo zahtev da se ova preraspodela u kategoriju za kapitalne investicije se prebaci u projekat koji se taj dodatak budžeta traži.
**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica** –ima li diskusije po ovoj tački, ako nemate diskusije stavljam na glasanje,
**Ko je za usvajanje ove tačke?**
**Za...........................16**
**Protiv......................0**
**Uzdržano................0**

**9. Razno**

**Liridon Kastrati-Predsedavaući Skupštine Opštine,** imate li drugih diskusija, ako nema današnju sednicu proglašavam zatvorenom.

Sednica završena u 10:55 časova

Prevod: Rexhep Ibrahimi

**Zapisničarka**
______________________
**Sabile Arifi**

**Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenicas**
______________________
**Liridon Kastrati**

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TE QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 26348
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 19/08 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.323 datë:15.08.2024**

Bazuar në nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja b) dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit (Nr.03/L-040) për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016), nenin 12 paragrafi 2 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenit 70 shkronja h) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, bazuar në vlerësim të ligjshmerisë së MAPL-së Nr.020 – 435/4, dt. 04.07.2024 për Vendimin Sh.02.Nr.21033 të dt. 02.07.2024 Për Mbylljen e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF-së) Qendër, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _________2024, sjell këtë:

**PROPOZIM - VENDIM**

**Për Shfuqizim të Vendimit Sh.02.Nr.21033 të dt. 02.07.2024 Për Mbylljen e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF-së) Qendër**

1. **SHFUQIZOHET** Vendimi Sh.02.Nr.21033 të dt. 02.07.2024 Për Mbylljen e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF-së) Qendër.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi Sh.02.Nr.21033 të dt. 02.07.2024 K.K. Kamenicë. Për Mbylljen e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF-së) Qendër.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe QSHQ- arkivi.*

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 26341
Nr. i faq. 1 Data: Datum: 19/08 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.322 datë:16.08.2024**

Bazuar në nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja b) dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit (Nr.03/L-040) për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016), nenin 12 paragrafi 2 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenit 70 shkronja h) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, bazuar në vlerësim të ligjshmerisë së MAPL-së Nr.020 – 435/11, dt. 15.08.2024 për Vendimin Sh.02.Nr.21061 të dt. 02.07.2024 Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Veton Kallaba B.I" me procedurë të negocimit të ofertës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më __________2024, sjell këtë:

**PROPOZIM - VENDIM**

**Për Shfuqizim të Vendimit Sh.01.Nr.21061 të datës 02.07.2024 Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Veton Kallaba B.I" , me procedurë të negocimit të ofertës**

1. **SHFUQIZOHET** Vendimi Sh.01.Nr.21061 të datës 02.07.2024 Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Veton Kallaba B.I" , me procedurë të negocimit të ofertës.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi Sh.01.Nr.21061 të datës 02.07.2024 K.K. Kamenicë, mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunes për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Veton Kallaba B.I", me procedurë të negocimit të ofertës.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet****: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe QSHQ- arkivi.*

**Kryetar i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVES – KOMUNA E KAMENICËS – KRYETARI – KAMENICA – KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 26342
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 19/08 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.324 datë:16.08.2024**

Bazuar në nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 13 dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit (Nr.03/L-040) për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016), nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenit 70 shkronja h) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, bazuar në vlerësim të ligjshmerisë së MAPL-së Nr.020 – 435/10, dt. 15.08.2024 për Vendimin Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _________2024, sjell këtë:

## PROPOZIM VENDIM

1. Me këtë Vendim bëhet shfuqizimi i pjesërishëm i Vendimit Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës.

2. SHFUQIZOHET pika 1.2 nga Vendimi Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024, si në vijim:

   **2.1** Pika 1 paragrafi 1.2 (*Njësia kadastrale me nr. P-71107079-01372-0, vendi i quajtur, "Vijanski Rid" me sipërfaqe prej 4872 m², në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës*) të Vendimit Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës.

3. Mbetet në fuqi pjesa tjetër e Vendimit Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës.

4. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa mbikëqyrjen për zbatimin e tij e bënë Kryetari i Komunës.

5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Vendimi Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim

afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës.

6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe QSHQ- arkivi.*

**Kryetar i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

**A r s y e t i m**

Vendimi Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatgjatë përmes Procedurës së Negocimit, Në kuadër të detyrimeve tona për të siguruar përputhshmërinë e vendimeve të Komunës me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe në vijim të kërkesës dhe rekomandimeve të pranuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), kemi shqyrtuar Vendimin Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës, me të cilin u miratua dhënia e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë përmes procedurës së negocimit. Gjatë këtij procesi, është identifikuar se pika 1.2 e këtij vendimi nuk është në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 06/1-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Konkretisht, janë vërejtur këto mangësi:
Mospublikimi në Wefaqen Zyrtare të Komunës Parcela kadastrale nr. 71107079-01372-0 nuk është publikuar në listën e përgjithshme dhe të veçantë të pronave për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024 në webfaqen zyrtare të komunës, siç kërkohet nga neni 13 i Ligjit Nr. 06/L-092. Ky publikim është një kërkesë thelbësore për të garantuar transparencën dhe ligjshmërinë e procedurës së dhënies së pronës në shfrytëzim.
Mungesa e Harmonizimit me Dokumentet e Planifikimit Hapësinor Parcela e përmendur nuk është argumentuar si në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) ose Hartën Zonale, gjë që është një kërkesë ligjore sipas nenit 5 të Ligjit Nr. 06/L-092. Qëllimi i shfrytëzimit të pronës komunale duhet të jetë i harmonizuar me dokumentet e planifikimit hapësinor, për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm dhe interesin publik të Komunës. Bazuar në këto mangësi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar ndërmarrjen e masave të duhura për rishqyrtimin e aktit dhe harmonizimin e tij me legjislacionin në fuqi. Në përputhje me këtë rekomandim kemi shfuqizuar pikën 1.2 të Vendimit Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës. Ky shfuqizim është i nevojshëm për të adresuar mangësitë e identifikuara dhe për të siguruar që procedura e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim të kryhet në përputhje me parimet e transparencës dhe ligjshmërisë.
Në përfundim, shfuqizimi i pikës 1.2 të vendimit është një hap i rëndësishëm drejt harmonizimit të këtij akti me legjislacionin në fuqi, duke shmangur shkeljet ligjore dhe duke ruajtur integritetin e procesit vendimmarrës në Komunën e Kamenicës.